

PERMBLEDHJE JOTEKNKE E RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Per Aktivitetin:

“NDERTIM HEC - “FAQEKUQ 3”

Vendodhja: Ne fshatin Vlush dhe Turbohova, ne Njesine Administrative Leshnje, Bashkia Skrapar, Qarku Berat

Kërkues: Subjekti “MER ENERGJI” Sh.p.k

Janar, 2022

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
Kapitulli 2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TEKNIK	3
2.1 Vendodhja e zonës së projektit	3
2.2 Karakteristikat hidrologjike të perrenjeve ushqyes te ketij HEC-i.....	3
2.3 Skema e shfrytëzimit dhe kriteret e përzgjedhjes.....	4
2.4 Përshkrim i shkurtër i skemës së shfrytëzimit.....	5
2.5 Përshkrim i veprave inxhinierike	5
2.5.1 Vepra e Marrjes (Derivacioni)	5
2.5.2 Vepra e transportit te ujit pa presion	5
2.5.3 Dekantuesi	5
2.5.4 Baseni i presionit.....	6
2.5.5 Vepra e Tubacionit te Turbinave (presionit).....	6
2.5.7 Ndërtesa e centralit	6
2.7 Bilanci i rrjedhës ujore, nevojat ekologjike, bujqësi e përdorues të tjerë	6
2.8 Lidhja me sistemin kombëtar të energjisë elektrike	7
Kapitulli 3 PËRSHKRIMI I KUSHTEVE TË MJEDISIT NË ZONË.....	7
3.1 Mjedisi fizik.....	7
3.1.1 Gjeologjia	7
3.1.2 Gjeomorfologjia	7
3.1.3 Tokat	8
3.1.4 Ujërat	8
3.1.5 Klima.....	8
3.2 Mjedisi biologjik	8
3.2.3 Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës në zonë	9
3.3 Mjedisi socio-ekonomik.....	9
3.3.2 Ekonomia	9
Kapitulli 4 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT	11
4.1 Metodika e aplikuar për vlerësimin ndikimeve në mjedis	11
4.2 Identifikimi i ndikimeve në fazën e përgatitjes dhe ndërtimit të veprave inxhinierike	11
Kapitulli 5 PLANI I MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE.....	12
5.1 Plani i masave të nevojshme për zbutjen e ndikimeve	12

HYRJE

Nëpërmjet projektit të propozuar shoqëria “MER ENERGJI” shpk synon shfrytëzimin e perroit të “Kapinovës” për prodhimin e energjisë elektrike duke shfrytëzuar një sasi të ujit rrjedhes sipërfaqësor, duke përdorur metodën e devijimit me tubacion derivacioni dhe me basen presioni, pa ndërtim rezervuarësh apo digash.

Prodhimi i energjisë elektrike do të mundësohet nëpërmjet përdorimit të turbinave të tipit Francis me kapacitet mesatar vjetor të prodhimit të energjisë rreth $E_{vj} = 3.9 \text{ GWh/vit}$.

Shqipëria përballet akoma me vështirësi në plotësimin e nevojave të vendit me energji elektrike. Aktualisht mbi 95% e energjisë elektrike sigurohet nga hidrocentralet megjithatë një pjesë të konsiderueshme e energjisë importohet, pjesë e cila varion – në varësi të kushteve vjetore – midis 30% dhe 60% të totalit të furnizimit me energji primare.

Prodhimi i energjisë elektrike duke shfrytëzuar burimet ujore, si përdorim i energjisë së natyrës apo burimeve të rinovueshme, qëndron në thelb të strategjive të prodhimit të energjisë në shkallë botërore, që synojnë uljen e varësisë nga energjia fosile.

Qeveria Shqiptare e ka konsideruar promovimin e përdorimit të energjive të rinovueshme, ku përfshihen edhe burimet hidrike, si një mjet të rëndësishëm të politikave të energjisë për rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, zhvillimin ekonomik, qëndrueshmërinë e sektorit të energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit

Në “Planin Kombëtar të Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme në Shqipëri”, parashikohet që për periudhën 2015-2020, të shtohet konsumi i burimeve të energjisë të rinovueshme në masën 38% e barabartë me 830 MW fuqi e instaluar, ku 750 MW nëpërmjet ndërtimit të HEC-eve të vegjël.

Në përputhje edhe me këto politika, shoqëria “MER ENERGJI” shpk ka përgatitur projektin e shfrytëzimit të kapaciteteve hidroenergjitike të perroit të “Kapinovës”, zbatimi i të cilit do të shënojë një impakt pozitiv në ekonominë lokale dhe do të kontribuojë në drejtim të rritjes së prodhimit vendas të energjisë.

Shoqëria “MER Energji” shpk, disponon kontrate Koncensionare të formës “BOT” (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e Hidrocentralit “FAQEKUQE III”, me nr. 2183 Rep dhe 1145/3 Kol, me date 16, tetor 2018. Ndërtimi i kësaj vepre do të ndodhet në mesin e një kaskade vepresh të njëjtë subjekti.

Ky raport është përgatitur për të parashikuar dhe analizuar ndikimet e mundshme në mjedis nga ndërtimi dhe funksionimi i “HEC FAQEKUQ 3”. Synimi kryesor i përgatitjes së këtij raporti paraprak është identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedisin pritës ku do të ndërtohet HEC-i dhe përputhshmërinë e tij me politikën e mbrojtjes së mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në zonën ku do të zbatohet projekti.

Për një vlerësim sa më objektiv dhe për adresimin e çështjeve më të rëndësishme që lidhen edhe me interesin e aksionerëve, është kryer një shqyrtim i kujdesshëm i projektit për të përcaktuar në mënyrë sa më reale ndërthurjet e tij me mjedisin.

Kapitulli 2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TEKNIK

2.1 Vendodhja e zonës së projektit

Vepra Ndertim HEC Faqekuq 3 do të ndertohej në pellgun ujëmbledhës të perroit të “Kapinoves” fshati Vlush, Fshati Turbohove, fshati Leshnje Nj. Ad Leshnje, Bashkia Corovode, Qarkut Skrapar.



Harta 2: Pozicioni i veprave inxhinerike në ortofoto.

Tabela 1: Koordinatat e veprave të projektit

Pikat	KRGJSH			GAUSS KRUGER	
	X	Y	Z	X	Y
Vepra e Marrjes	52 86 27	44 888 73	806 m	44 440 32	44 891 56
Pika e shkarkimit, Godina e centralit	52 65 98	44 858 50	725 m	44 419 69	44 861 59

E gjithë zona përshkohet me rrugë të kategorisë së tretë që lidhin fshatrat ndërmjet tyre, rrugë të cilat aksesojnë ndërtimin e veprave të këtij Hec.

2.2 Karakteristikat hidrologjike të perrenjeve ushqyes të këtij HEC-i

HEC Faqekuq 3 është projektuar të shfrytëzojë ujërat e perroit të “Kapinoves” me anë të 1 veprave marrjeje, me sipërfaqe të përgjithshme të pellgut prej 55 km². Zona në studim ndodhet në pjesën e sipërme të pellgut ujëmbledhës të perroit të “Kapinoves”.

Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës i veprës së marrjes 55 km², ndërsa lartësia e pellgut H = 1200 m.

Burimet në këtë zonë janë të shumta, dhe të shpërndara në pjesën e sipërme të Faqekuqit që është me kryesore, si edhe disa burime të tjera shiko hartën hidrologjike të mëposhtme.


Ne këtë zone ndodhet edhe një shtrese me ngjyrë kafe te hapur, e cila përfaqëson shtrese e shkëmbinjve te carë dhe poroze me ujëmbajtës lokale ose shume te varfër ne ujerat e nëntokës.

2.3 Skema e shfrytëzimit dhe kriteret e përzgjedhjes

Shfrytëzimi hidroenergjetik i lumit te Kapinoves (Vlushes) është realizuar tashme me tre hidrocentrale te Ndërtuara dhe Hidrocentrali Faqekuq 3 ne këtë pozicion zbritës është Hec-i katërt.

Skema e këtij lumi është përfundimisht e shfrytëzuar me ndërtimin e kësaj vepre, dhe kjo vepër e fundit do te përdore infrastrukturën e ngritur te veprave te tjera ekzistuese.

Hidrocentrali Faqekuq 3 pozicionohet ne lumin Kapinove ndërmjet kuotave 800 m deri ne kuote 720 m. Hidrocentrali Faqekuq 3 do te ketë te instaluar fuqin 1300 KW ose 1,3 MW.



Harta 4: Vendodhja e veprave te marrjes dhe Godines se Centralit ne ortofoto.

Vepra e marrjes do te jete e tipit me marrje anësore dhe kjo është përzgjedhur për shkak te terrenit malor. Rënia bëhet pothuajse krejtësisht nga derivacioni sepse vepra e marrjes është e ulët që ndërtohet në fillim shërben sa për të kthyer, nëpërmjet veprës së marrjes, prurjen e përroit për në derivacion.

Derivacioni ka si funksion të përqëndrojë prurjen në pjesën më të madhe të rënies. Derivacioni do të realizohet me tubacion, ose me kanal te mbuluar betonarme. Prerja tërthore e tubacionit do të jetë rrethore, ose katër këndore te cilat janë format më te përshtatshme hidraulike se shtrati i lumit, ndërsa faqet e brendshme me ashpërsi shume te vogël, se ashpërsia e rrjedhës.

2.4 Përshkrim i shkurtër i skemës së shfrytëzimit

Vepra e marrjes së HEC Faqekuq 3 (ujëlëshuesi) do të funksionoj plotësisht vetëm kur Hec Faqekuq 2 nuk do të jet në punë. Uji nga Faqekuq 1 nepermjet kanalit të shkarkimit do të derdhet direkt në dekantuesin e Faqekuq 3.

Ujëlëshuesi (vepra e marrjes) do të ndërtohet mbi strukturën e vjetër dhe me pas do të ndërtohet kanali i derivacionit pa presion me gjatësi 250 m, i cili do të dërgoj ujin për në Dekantues.

Tubacioni i turbinave do të ketë një gjatësi prej 3850 m dhe do të ndërtohet nëntokë. Ky tubacion do të bëjë të mundur transportin me presion nga baseni për në ndërtesën e centralit. Uji pas shfrytëzimit energjetik nëpërmjet kanalit të shkarkimit do të derdhet përsëri në lumin Vushë.

Turbina do të jetë e tipit Francis dhe do të instalohen në godinën e HEC-it, ku do të jenë edhe gjeneratorët e prodhimit të energjisë dhe transformatori i energjisë.

2.5 Përshkrim i veprave inxhinierike

2.5.1 Vepra e Marrjes (Derivacioni)

Hidrocentrali "FAQEKUQ 3" burimin e ujit do ta ketë nga përroi i Kapinoves në kuotën 800 m.

Vepra e marrjes [v.m.] do të vendoset në shtratin e përroit në kuotën 800 m. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës që formohet në këtë kuotë është 55 km².

Vepra e marrjes (ujëlëshuesi) së Hidrocentralit Faqekuq 3, në përroin e Kapinoves ka një karakteristike të veçante. Ujëlëshuesi do të funksionoj plotësisht kur hidrocentrali Faqekuq 2 nuk është në punë. Uji nga Hidrocentrali Faqekuq 1 nëpërmjet kanalit të shkarkimit do të derdhet direkt në dekantuesin e Hidrocentralit Faqekuq 3.

2.5.2 Vepra e transportit të ujit pa presion

Transportimi i ujit nga ujëlëshuesi deri në dekantues do të bëhet në krahun e djathtë të rrjedhës së ujit. Gjatësia e saj është 250 m dhe do të bëhet pa presion i cili është parashikuar me seksion rrethor, por në llogaritë janë vendosur edhe seksioni katërkëndësh dhe trapezoidal. Kjo për faktin se gjatë fazës së kontraktimit të punimeve mund të ketë ndryshime për efekt të kostos.

Kuota e tabanit të kanalit në hyrje do të jetë 806.00 m dhe kuota në dalje pas 250 m dhe njëkohësisht e hyrjes së ujit në dekantues do të jetë 803.00 m

2.5.3 Dekantuesi

Dekantuesi është një vepër hidroteknike që shërben për mbajtjen e aluvjoneve me një diametër të caktuar. Në projektin tonë dekantuesi shërben për të mbajtur aluvjonet që të mos kalojnë në basenin e presionit dhe të mos shkojnë në tubacionin e turbinave nga ku mund të dëmtojnë turbinat.

Zgjedhja e tipit të dekantuesit është bërë në funksion të kushteve të lumit dhe të sasisë së ujit që kërkohet.

Në kushtet tona zgjedhëm dekantues me shpërlarje periodike dhe mënyra e shpërlarjes do të jetë me metodën hidraulike. Parimi i punës së këtij dekantuesi është krijimi i një vëllimi të vdekur ku depozitohen aluvjonet që dekantohen dhe me metodën e shpërlarjes me ujë bëhet largimi i këtyre

aluvjoneve te grumbulluar. Kjo shpëlarje bëhet atëherë kur shikohet se mbushja e vëllimit të vdekur të dekantuesit ka arritur fundin. Frekuenca e shpëlarjeve varet nga sjellja e prurjeve të ngurta të lumit, p.sh. në stinën e shirave ky vëllim mbushet më shpejt se në stinën e thatë.

2.5.4 Baseni i presionit

Baseni i presionit bën lidhjen e derivacionit nga kanali pa presion me tubacionin e turbinave. Në dimensionim duhet patur parasysh që të respektohet shpejtësia e hyrjes së ujit në zgarë 1-1.2, pastrimi do të bëhet me mekanizëm. Nuk duhet të zbulohet tubi në rastin e vënies së turbinës në punë.

Uji i cili do të shkarkohet do të kalojë në pragun kapërderdhës të shkarkuesit, por ne kete rast shkarkuesi do te jete ne strukturen e dekantuesit qe eshte vendosur ne murin e kundërt te shkarkuesit për ne basenin e presionit dhe do të grumbullohet në pusetën e përbashkët në shkarkuesin fundor te dekantuesit dhe me tubacionin e shkarkimit do të derdhet në përrua (shiko planin e përgjithshëm),

2.5.5 Vepra e Tubacionit te Turbinave (presionit)

Derivacioni me presion “Tubacioni i Turbinave” bën lidhjen hidraulike nga baseni i presionit për në turbinë. Tubacioni i turbinave është trasuar si në planimetri, përgjatë tarracës se pare lumore te përroit te Vlushes dhe bën lidhjen hidraulike nga niveli i ujit ne basenin e presionit nga kuota 800 m deri ne kuotën 725 m qe do te jete aksi i turbinës, tubacioni është i gjatë 3850 m.

2.5.7 Ndërtesa e centralit

Ndërtesa e hidrocentralit do te ndërtohet ne krahë te rrjedhës se lumit Vlusha mbi tarracën e pare lumore si edhe 5 m mbi veprën e marrjes se hidrocentralit Vushë. Ndërtesa e hidrocentralit do te ketë sipërfaqe ndërtimi 410 m².

Ndërtesa do te jete e kompozuar me sallën e makinerive, komandimit, transformatorët, magazine, ambiente ndihmese, nënstacioni, etj.

2.7 Bilanci i rrjedhës ujore, nevojat ekologjike, bujqësi e përdorues të tjerë

Marrja e prurjes së ujit dhe ndryshimi i drejtimit të rrjedhës për në basenin e rregullimit, shoqërohet me ndryshim në ekologjinë e shtratit të lumit Kapinova , që mund të shkaktojë modifikim të sistemit ekologjik.

Për këtë arsye del e nevojshme që gjatë periudhës së shfrytëzimit të HEC-it të lihet një sasi uji për të siguruar regjimin normal të zhvillimit ekologjik.

Projekti parashikon lënien e një rrjedhe ujore minimale rreth :

$$V.M = 0.151 \text{ m}^3/\text{sek} .$$

Leshimi i ujit ekologjik do te behet nepermjet nje hapesire e cila do te lihet te porta e vepres se marrjes per periudhen e thate korrik-gusht-shtator, ndersa per muajt e tjerë kjo gjë mund te mos jete e nevojshme pasi gjatë shtratit të lumit rrjedhin burime anësore.

2.8 Lidhja me sistemin kombëtar të energjisë elektrike

Lidhja me sistemin energjistik kombëtar do të bëhet me nënstacionin më të afërt i cili degezimi i Linje Faqkuq 2 - Nestacioni i ri i Corovodes .

Kapitulli 3 PËRSHKRIMI I KUSHTEVE TË MJEDISIT NË ZONË

Në këtë kapitull do të përshkruhen karakteristikat fizike, biologjike, socio-ekonomike si dhe gjendja e mjedisit ku do të zhvillohet projekti.

3.1 Mjedisi fizik

3.1.1 Gjeologjia

Gjeologjikisht, rajoni në studim bën pjesë në Zonën Tektonike kruja dhe brenda saj në nënzonën Tomorri. Kjo nënzonë përfshin rajonet në jug të thyerjes tërthore Vlorë-Elbasan-Dibër dhe ndërtohet nga një radhë strukturash të tipit antiklinale me periklinale dhe qafa ndarëse të dallueshme. Zona në studim gjendet në vargun antiklinal Tomorr-Çorovodë-Melesin, i cili përfaqëson edhe vargun më përëndimor të zonës Kruja. Në qendër të këtyre antiklinaleve janë prezentë depozitimet e Oligocenit të poshtëm dhe atij të mesëm.

Sizmiciteti

Bazuar në neotektonikat dhe sizmicitetin e Shqipërisë, në zonën e studimit dallohet zona sizmogjenike gjatësore Joniano-Adriatike dhe ajo transversale Lushnje-Elbasan-Dibër. Zona tektonike Jonike përgjithësisht zgjatet sipas drejtimit VP-JL në territoret e jashtme të regjimit kompresional. Kjo zonë tektonike përmbledh një numër thyerjesh mbulesore, aktive, gjatësore dhe rrallë thyerje mbulesore të përmbysura, të shkëputura nga thyerjet me spostim horizontal, i cili bazuar në studimet përkatëse është akoma aktiv dhe sizmogjenik.

Në këtë territor mund të bien tërmete me Mmax të pritshëm midis 6.0 dhe 6.9 (Aliaj, 2004). Sipas Hartës së Sizmicitetit të Shqipërisë ky territor inkludohet në Zonën e Shkallës VII të MSK-64, të shkallës së intensitetit sizmik.

3.1.2 Gjeomorfologjia

Nga pikpamja gjeomorfologjike, zona e propozuar për ndërtimin e HEC-it shtrihet përgjatë luginës së përroit të Kapinoves, që nga burimet e rrjedhjes e deri në derdhjen e tij në lumin Osum. Ky sektor dallohet për reliev shumë të çrregullt kryesisht për shkak të përbërjes litologjike të shkëmbinjve që

ndërtojnë territorin, tektonikave aktive dhe proceseve gjeodinamike. Zona ne studim ndodhet ne pjesen e sipërme te pellgut ujembledhes te perroit te Kapinoves. Objektet ne studim perfshihen ne perroitin e Kapinoves ne pjeset e sipërme te tije ne kuotat 800-720 m mbi nivelin e detit.

Ne perroitin e Kapinoves eshte planifikuar te ndertohen nje veper marrje ne kuoten 800 mnd dhe godina e centralit ne kuoten 720 m. Konfiguracioni orografik i zones ne studim paraqitet ne pjesen e sipërme krejtesisht malor, i ashper shpesh here te thella dhe me erozion te zhvilluar.

3.1.3 Tokat

Në zonën e objektit janë të përhapura kryesisht Tokat e kafenjta malore dhe më pak ato të murrme pyjore, në sektorët më të lartë.

Tokat e kafenjta malore janë të shpërndara sipas ligjësisë së zonalitetit vertikal duke u shtrirë në lartësinë nga 600 m në 1000 m mbi nivelin e detit. Ato formohen në kushtet e klimës mesdhetare malore, me regjim hidrik të ndryshueshëm dhe kryesisht mbi shkëmbinj sedimentarë. Tokat e kafenjta zhvillohen në kushtet e një relievi shumë heterogjen e me pjerrësi të theksuar, për këtë arsye janë objekt i një erozioni intensiv.

3.1.4 Ujërat

Shqipëria si edhe zona ne studim eshte e pasur me ujerat nentokesore. Kjo lidhet me shume faktore, por rol te madh sigurisht luajne sasia e madhe e rreshjeve dhe shumllojshmeria e formacioneve shkembore, ne te cilat perhapje te madhe kane formacionet karbonatike te pershkueshme nga uji.

Burimet te ne kete zone jane te shumta, dhe te shperndara ne pjesen e sipërme te Faqekuqit qe eshte me kryesore, si edhe disa burime te tjera .

3.1.5 Klima

Pellgu ujembledhës i perroit te Faqekuqit dhe te Kurshoves, sipas ndarjes klimatike te Shqipërisë, shtrihet ne zonën Mesdhetare Malore -Jugore.

Kjo zone karakterizohet ne përgjithësi nga një regjim mesdhetar i kushteve klimatike me vera te thata e te freskëta dhe dimra te ftohte e te laget.


Pa hyre ne interpretimin e te gjithë elementeve te cilët karakterizojnë klimën e nje rajoni te dhënë do te shqyrtojmë me gjerësisht dy nga parametrat klimatike me te rëndësishëm qe njëkohësisht paraqesin interes për njohjen e rezervave ujore:



Temperatura e ajrit dhe Reshjet atmosferike.

Për te evidentuar keto kushte klimatike janë marre ne konsiderate te dhënat e stacioneve meteorologjik Corovode (=40o 30', =20o 13', Hs=410m), Korite (=40o 32', =20o 16', Hs=950m) dhe Potom (=40o 29', =20o 23', Hs=980m) te cilët e rrethojnë këtë pellg ujembledhës.

3.2 Mjedi biologjik

Zona e studimit shtrihet në fshatin Faqekuq, Skrapar, dhe përfshin gjithë mjedisin përgjatë përrrenjve Faqekuq dhe Kapinove, te cilet derdhen ne Lumin e Vluses, dege e lumit Osum. Sipërfaqja e parapërcaktuar për studimin e florës dominohet nga:

 Habitati pyjeve bregore te perroit;

-  Habitati tranzitor – shkurre; dhe
-  Habitati pyjor – shkurre i perzier, i dominuar nga lisi.

3.2.3 Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës në zonë

Pavarësisht pranisë së kanioneve të shumta në luginën e Osunit të mesëm, zona e zhvillimit të projektit nuk ndërpret asnjë prej tyre.

Njëkohësisht referuar hartës së Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë (MM, korrik 2014), zona e projektit nuk ndërpret asnjë nga Zonat e Mbrojtura dhe Monumentet e Natyrës së Shqipërisë.

3.3 Mjedisi socio-ekonomik

Zona Gjeografike Bashkia Skrapar : Skrapari kufizohet në veri me bashkinë Gramsh, në perëndim me bashkitë Berat dhe Poliçan, në jug-perëndim me bashkinë Këlcyrë, në jug me bashkinë Përmet dhe në lindje me bashkitë Maliq e Korçë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Çorovodës.

Administrativisht zona ku do ndërtohet Hec-i gjendet në territorin e Bashkisë Skrapere në Njësinë Administrative Lesgnje. Qendrat e banuara më të afërta është fshati Façekuq, Vlushë dhe Turbohove. E gjithë zona përshkohet me rrugë të kategorisë së tretë që lidhin fshatrat ndërmjet tyre.

3.3.2 Ekonomia

Rrethi i Skraparit karakterizohet nga një pranverë e hershme, verë e thatë dhe vjeshtë e dimër relativisht të lagësht, shoqëruar nga bora dhe ngrica në disa pjesë, faktorë që kanë nxitur rritjen e prodhimit të frutave, vreshtave dhe blegtorisë që nga viti 1997.

Sipërfaqja e mbjellë me drithëra në rrethin e Skraparit zvogëlohet çdo vit. Megjithatë, në nivel rrethi drithërat ende mbulojnë afërsisht 30% të tokës bujqësore. Përdorimi kryesor i drithërave është si ushqim për bagëtitë, ndërsa përdorimi i tyre në bërjen e bukës ka qenë i reduktuar vetëm në disa nga fshatrat më të largëta. Sipërfaqja e dedikuar për kultivimin e perimeve është e vogël, por ka ardhur në rritje gjatë viteve të fundit. Perimet janë rritur për qëllime konsumi familjar, me përjashtim të disa fshatrave përreth qyteteve të Çorovodës dhe Poliçanit, të cilët gjithashtu prodhojnë për të shitur perimet e tyre në këto qytete. Qasja e dobët e tregut, kostot e larta të prodhimit dhe faktorët klimatikë kanë kufizuar kultivimin e perimeve për treg.



Zhvillimi i vreshtarisë është karakterizuar nga rehabilitimi i vreshtave ekzistuese të degraduara dhe mbjellja e vreshtave të reja duke përdorur teknologjitë bashkëkohore me varietete të rrushit, të specializuara kryesisht për prodhimin industrial të verës dhe rakisë (Eau-de-vie). Është vlerësuar së sipërfaqja me vreshta do të vazhdojë të rritet.

Megjithatë, pyjet dhe kullotat mbeten resurset më të rëndësishme. Zona e mbuluar me pyje dhe kullota është afërsisht katër (4) herë më të madhe se ajo e tokës për kultivim. Blegtoria dhe bagëtitë e imta janë një aktivitet në rritje në këtë zonë për shkak të kullotave të bollshme dhe me cilësi të lartë. Sipas ekspertëve nga ish-Bashkia e Çorovodës (sot qendra e bashkisë së re Skrapar), fermat në këtë rreth hasin në dy sfida kryesore. I pari është një problem i qasjes së ujit për ujitje, përkundër resurseve të ujit në të gjithë zonën dhe mungesës së kanaleve të ujitjes në terrenin kodrinor. Sfida e dytë është qasja në tregje.

Skrapari si burim kryesor ka të ardhurat që vijnë nga blegtoria dhe bujqësia, prodhime mjaft të vlerësuara këto në tregjet e vendit, ndër më të njohurat djathi dhe rakia e Skraparit. Vitet e fundit Skraparit i është shtuar shpresa për zhvillimin nëpërmjet turizmit. Kanionet e Skraparit, po tërheqin çdo ditë e më shumë vëmendjen e vizitorëve të huaj dhe vendas.

Mbi 20 mijë vizitorë mendohet se kanë prekur këtë bukuri të natyrës katër vitet e fundit. Turizmi fetar është një tjetër resurs i kësaj zone. Mijëra vizitorë shkelin në Skrapar çdo vit gjatë festës së Bektashinjve, gjatë ditëve të pelegrinazhit të muajit gusht. Por dhe këtë resurs të turizmit e pengon gjendja e vështirë e rrugës në fshatin Gjerbës, nga ku vizitorët duhet të udhëtojnë drejt malit të shenjtë Tomor.Parku Kombëtar i Tomorit, është një tjetër resurs mjaft i rëndësishëm i kësaj zone, ende i pa vënë në shërbim të turizmit malor, si rezultat i mungesës së infrastrukturës dhe shërbimeve. Bashkimi i komunës Bogovë me Skraparin, i jep kësaj bashkie të re një tjetër mundësi për zhvillimin e turizmit. Uji që rrjedh nga zemra e malit, kodrat e hijshme, klima mjaft favorizuese dhe ushqimet e shijshme, i japin zonës elemente mjaft pozitive për zhvillimin e turizmit natyror. Ndryshe me pjesën tjetër të rrethit, nga Bogova nuk ka pasur lëvizje të mëdha të popullsisë. I gjithë fshati jeton me të ardhurat nga turizmi familjar. Pjesë e kësaj komune është fshati Novaj i njohur për gurin dekorativ.

Ndonëse vetëm 30 km larg qytetit të Corovodes, zona e Potomit me fshatërat e saj Qafë, Potom, Staraveckë dhe Backë konsiderohej si zonë shumë e largët për shkak të amortizimit të rrugës. Projekti TAP, rruga e re me standarte që është ndërtuar, pritet që ta afrojë këtë zonë mjaft të pasur me resursë natyrore, në fushën e turizmit, për ta shëndërruar në destinacione të preferuara turistike. Pozicioni gjeografik, afërsia me Korcen, produktet cilësore të zonës, projektet e Bashkisë, pritet që në një të ardhme të afërt ta zhvillojnë këtë zonë nëpërmjet turizmit natyror dhe atij familjar.

Lidhur me tre fshatrat e prekura nga ky projekt specifikisht fshati Leshnje , Turbohove dhe Vlushe për shkak të terrenit të vështirë malor dhe resurseve të pakta natyrore ka një mungesë të fronteve të punës si punë të përhershme . Fronte të punës në këto fshatra janë vetëm këto opsione ;

1.Rritja e bagetive

2.Puna në karriera guri gelqeror

3.Punetore kraku për veprat e infrastruktures dhe ndertimi të ndonjë investimi në zonë

4.Punë krahu për të mbjellë toka bujqesore

Kapitulli 4 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT

4.1 Metodika e aplikuar për vlerësimin ndikimeve në mjedis

Veprimtaritë që zhvillohen në mjedis shoqërohen edhe me ndikimet ndaj tij që janë pjesë e pashmangshme e zhvillimit ekonomik dhe social. Megjithatë është e detyrueshme që, edhe në përputhje me procedurat ligjore, këto ndikime në mjedis të vlerësohen, diskutohen dhe të bëhen pjesë e procesit vendimmarrës. Gjithashtu është e rëndësishme që të bëhen përpjekje të arsyeshme dhe të mundshme që pasojat në mjedis të ndikimeve të jenë sa më minimale dhe në përputhje me normat ligjore në fuqi. Në këtë kontekst vlerësimi i ndikimeve të mundshme në mjedis si pasojë e zbatimit të projektit të propozuar është kryer duke u bazuar në natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e funksionimit, sasinë e energjisë që do të prodhohet, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha nën kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis është analizuar sipas fazave të veprimtarisë si më poshtë:

- Në fazën përgatitore/instalimeve/ndërtimit të veprave inxhinierike;
- Në fazën e funksionimit të hidrocentraleve dhe prodhimit të energjisë elektrike.

Me këtë përqaasje do të paraqiten e trajtohen në vijim ndikimet e parashikuara si dhe masat që propozohen për minimizimin e pasojave të tyre në mjedis dhe mbrojtjen e mjedisit. Analiza e ndikimeve është treguar në paragrafët e mëposhtëm në mënyrë tabelare ku, në planin vertikal renditen operacionet/aktivitetet (ndërtimore ose operacionale) të projektit, në atë horizontal receptorët e ndikimit të tyre në mjedis, ndërsa në pikëprerjen e tyre jepen sqarime për mënyrën e ndikimit dhe pasojën e mundshme të tij në receptor të tilla si përgatitja e trasesë së tubacionit – dëmtimi i habitatit natyror etj.

4.2 Identifikimi i ndikimeve në fazën e përgatitjes dhe ndërtimit të veprave inxhinierike

Për një analizë sa më objektive të ndikimeve të mundshme në mjedis, fillimisht janë përcaktuar të gjithë aktivitetet/operacionet të cilat si pasojë e zhvillimit të ciklit të tyre mund të bëhen shkak për ndikime. Operacionet kryesore me ndikime të mundshme në mjedis në fazën e ndërtimit të veprës janë:

- Ndërtimi i komponentëve inxhinierikë ku përfshihen: vepra e marrjes; dekantuesi; kanali i derivacionit ,baseni i presionit,tubacioni i turbinave dhe godina e centralit.
- Ndertimi i kanaleve te derivacionit dhe tubacioni i turbinave .
- Lidhja me sistemin (shtyllat e linjës së transmetimit).

Kapitulli 5 PLANI I MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE

Për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis të identifikuar në seksionin paraardhës, kompania do të zbatojë një plan masash zbutëse i cili ka për qëllim parandalimin ose minimizimin e ndotjes dhe dëmtimit të mjedisit si dhe shëndetin e sigurinë në punë. Plani i masave synon respektimin e standardeve mjedisore gjatë kryerjes së aktiviteteve ndërtuese të HEC-eve dhe më pas shfrytëzimit të tij, në mënyrë të sigurt dhe efektive, me qëllim final mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit. Konkretisht, ai fokusohet në ndikimet e identifikuar në mjedis në fazat e ndërtimit dhe të shfrytëzimit të veprës, masat përkatëse mënjuese ose minimizuese dhe institucionet përgjegjëse.

5.1 Plani i masave të nevojshme për zbutjen e ndikimeve

Masat kryesore të propozuara adresojnë zgjidhje të mundshme dhe të përshtatshme për minimizimin e ndikimeve negative në mjedis të identifikuar gjatë VNM. Këto masa duhet të synojnë:

- Rehabilitimin e sipërfaqeve që do të përdoren dhe ndikohen nga veprimtaria ndërtimore.
- Minimizimin e dëmtimeve të biodiversitetit (vegjetacionit dhe habitatit).
- Sistemimin e masës inerte që do të dalë nga; përdorimin e një pjese të tyre në mbushje (në ndërtimin e komponentëve të HEC).
- Kontrollin e erozionit.
- Lëshimin e prurjeve ekologjike dhe programimin e lëshimit përgjatë rrjedhës ekzistuese.

Zbatimi me korrektësi i këtyre masave do të bëhet i mundur nga përdorimi i teknikave të mëposhtme:

- Piketimi i saktë i sipërfaqes së ndërtimit dhe kufizimi i veprimtarisë vetëm brenda saj.
- Kontrolli i dherave të gjeneruara dhe sistemimi i tyre nëpërmjet kompaktësimit.
- Sistemimin e nevojshëm për drejtimin e ujrave të shiut me qëllim zvogëlimin e erozionit.
- Kontrolli i pluhurave nëpërmjet lagies së zonës së punës dhe mbulimit të makinerive gjatë transportit.
- Kontrolli teknik i mjeteve të punës për të parandaluar rrjedhjet e karburantit.